

TURIZMI NË SHIFRA

SHQIPËRI

2018



**Udhëtimi është një investim, nga ku del gjithmonë
më i pasuruar**

Parathënie dhe Mirënjuhje

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës nga viti 2013-2017, statistikatat në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish.

Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi turistët e huaj dhe vendas dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqipëtare.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar falë bashkëpunimit dhe të dhënave administrative të siguruara nga Banka e Shqipërisë, ministrinë dhe institucione të tjera.

Statistikat e turizmit janë nën fokusin e INSTAT, ku ka filluar puna për ndërtimin edhe të llogarive satelitet të turizmit.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.


Delina IBRAHIMAJ,
PHD Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT

Përmbajtja

Të dhëna të përgjithshme të Shqipërisë	3
Hyrje	6
1. Karakteristika të turistëve të huaj në Shqipëri	7
2. Karakteristikat kryesore të udhëtimeve të shtetasve Shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit	13
3. Sa i rëndësishëm është turizmi në ekonomi?	16
4. Kapacitetet akomoduese në Shqipëri	18
5. Aktivitete të tjera turistike	19
Aneksi 1:	20



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHQIPËRISË




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

SIPËRFAQJA TOTALE	28,748 km ²
POPULLSIA	2,9 milionë banorë
KRYEQYTETI	Tirana (0.86 milionë banorë)
GJATËSIA KUFITARE	1094 km
- GJATËSIA TOKËSORE	657 km
- GJATËSIA BREGDETARE	316 km
- GJATËSIA LUMORE	48 km
- GJATËSIA LIQENORE	73 km



KUSH?



SHQIPËRIA ËSHTË E PARAPËLQYER MË SHUMË
NGA TURISTËT KOSOVARË...

PSE?



4 NGA 10 SHTETAS TË HUAJ QË KANË HYRË NË
VENDIN TONË GJATË PERIUDHËS 2013-2017,
KANË ARDHUR PËR PUSHIME...

SI?




RRETH 8 NGA 10 SHTETAS TË HUAJ HYJNË
NË SHQIPËRI ME TOKË...

KUR?



GATI GJYSMA (48 %) E SHTETASVE TË HUAJ
VIJNË NË TREMUJORIN E TRETË...

SA?



PËR 10 SHQIPTARË, NË 2017, KA PATUR
RRETH 17 HYRJE TË SHTETASVE TË HUAJ...


Vetëm gjatë vitit 2017 janë dhënë leje për ndërtimin e 89 mijë metër katror sipërfaqe për "Hotele dhe të ngjashme", pothuajse aq sa janë dhënë për katër vite së bashku, 2013-2016 (88 mijë m2).



2017

2012 - 2016

14,4
SHTRETËR PËR 1000
BANORË (2016)



MË SHUMË SE 17.000 DHOMA DHE
41.000 SHTRETËR ISHIN NË
DISPOZICION TË TURISTËVE NË VITIN
2016.



HYRJE

Industria e turizmit zë një vend të kyç në ekonomi dhe është një burim i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Turizmi mund të japë një kontribut të rëndësishëm në tre dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm: të krijojë vende pune, të gjenerojë mundësi tregtare për të njohur nevojat dhe për të mbështetur aktivitete turizmi, të krijojë kapacitetet e rëndësishme të cilat promovojnë përparësitë për ruajtjen mjedisore dhe larminë kulturore.

Prodhimi i statistikave të harmonizuara me ofertën dhe kërkesën e turizmit, sot konsiderohet si vendimtar për t'u mundësuar vendimmarrësve të vlerësojnë dhe përmirësojnë këtë sektor të rëndësishëm ekonomik.

Duke iu referuar periudhës 2013-2017 statistikën në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë.

Ky material i përgatitur nga INSTAT publikohet për herë të parë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2013-2017 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga pesë kapituj. Kapitulli i parë paraqet karakteristikat e hyrjeve të shtetasve të huaj sipas rajoneve, mënyrës së udhëtimit, gjatësisë së qëndrimit, si edhe shpenzimet e turistëve të huaj në Shqipëri.

Kapitulli i dytë tregon daljet e rezidentëve shqiptarë jashtë vendit, shpenzimet sipas qëllimit të vizitës, destinacionet kryesore, etj.

Kapitulli i tretë paraqet disa tregues makroekonomikë si shpenzimet e turistëve të huaj në raport me PBB, shpenzimet e turistëve jashtë vendit ndaj totalit të importeve të mallrave dhe shërbimeve, vlerën e shtuar dhe numrin e punonjësve të aktiviteteve që lidhen direkt me turizmin.

Kapitulli i katërt fokusohet në kapacitetet akomoduese në Shqipëri, duke dhënë informacion mbi numrin e njësive akomoduese, numrin e dhomave gjithsej dhe numrin e shtretërve.

Kapitulli i pestë fokusohet në aktivitete të tjera turistike duke dhënë informacion mbi numrin e vizitorëve në parqe arkeologjike, në muze, në kala dhe monumente.

Gjetjet kryesore të shkruara në material tregojnë se hyrjet e shtetasve të huaj në periudhën 2013-2017 janë rritur mesatarisht 12,0 % ndërsa shpenzimet e turistëve të huaj (jo- rezidentë) në vendin tonë janë rritur mesatarisht 8,5 % për të njëjtën periudhë.


Në periudhën 2013-2017 daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur mesatarisht 7,2 % ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit janë rritur mesatarisht 2,2 %.

Në periudhën 2013-2017 numri i vizitorëve që kanë vizituar kalatë dhe monumentet ishte 621.061 persona, duke pasur rritjen më të madhe gjatë periudhës në shqyrtim, mesatarisht me 51,5 %.

1. Karakteristika të turistëve të huaj në Shqipëri

TË HUAJ TË HYRË NË VEND...


Në periudhën 2013-2017, hyrjet e shtetasve të huaj që vijnë në Shqipëri ka qënë afërsisht 21 milionë persona. Në këtë hark kohor, hyrjet e shtetasve të huaj kanë patur tendencë rritje mesatarisht prej 12,0 % në vit.




Hyrjet nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 92,4 % dhe janë rritur mesatarisht me 12,3 % gjatë periudhës 2013-2017. Në vitin 2017, hyrjet nga rajoni i Evropës janë rritur 4,5 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.



Shtetasit e huaj që hyjnë në Shqipëri vijnë kryesisht nga : Kosova (34 %), Maqedonia (13 %), Greqia (10 %), Mali i Zi dhe Italia (7 % secili).



CILAT MËNYRA TRANSPORTI JANË MË TË PËRDORURA?



Në periudhën 2013-2017, me rrugë ajrore kanë mbërritur afërsisht 2,1 milionë shtetas të huaj duke u rritur mesatarisht me 16,7 %. Në vitin 2017, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri me rrugë ajrore është rritur me 26,5 %, krahasuar me vitin e mëparshëm. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave ajrore zënë mesatarisht 10 % të hyrjeve gjithsej



Në periudhën 2013-2017, numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në Shqipëri me linja detare ka qënë afërsisht 1,3 milionë duke u rritur mesatarisht me 21,6 %. Në vitin 2017, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri me linja detare është rritur me 41,9 %, krahasuar me vitin e mëparshëm. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave detare zënë mesatarisht 6 % të hyrjeve gjithsej.



Në periudhën 2013-2017, numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në vendin tonë nëpërmjet tokës ka qënë afërsisht 17,5 milionë, duke u rritur mesatarisht me 10,8 %. Në vitin 2017, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri me rrugë tokësore është rritur me 3,6 %, krahasuar me vitin e mëparshëm. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet tokës zënë pjesën më të madhe me 84 % të hyrjeve gjithsej për periudhën 2013-2017.

TABELA 1. HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ SIPAS MËNYRËS SË MBËRRITJES, NË MIJË


NR.	PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
	HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ GJITHSEJ I+II+III	3.256	3.673	4.131	4.736	5.118
I	ME AJËR	314	337	401	457	578
II	ME DET	187	202	215	279	396
III	ME TOKË	2.755	3.134	3.515	3.999	4.144

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

CILAT PIKA KUFITARE PRESIN FLUKSIN MË TË MADH TË TURISTEVE TË HUAJ?


Pikat kufitare që presin fluksin më të madh të shtetasve të huaj që vizitojnë Shqipërinë janë: Morinë (40 %), Muriqan (12 %) dhe Rinas (12 %).

PIKA KUFITARE	HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ 2017	%
BLLADE	83.576	2 %
KAKAVIJË	235.900	5 %
QAFË BOTË	158.680	3 %
KAPSHITCË	177.685	3 %
QAFË THANË	342.543	7 %
MORINË	2,051.968	40 %
HANI I HOTIT	279.149	5 %
MURIQAN	631.523	12 %
DURRËS	163.575	3 %
SARANDE	201.411	4 %
RINAS	589.592	12 %
TË TJERA	202.098	4 %
TOTAL	5.117.700	100 %



CILAT GRUPMOSHA PREFEROJNË TË UDHËTOJNË NË SHQIPËRI?

Shqipëria është një atraksion turistik kryesisht për grupmoshën 25-44 vjeç referuar të dhënave të vitit 2017, për hyrjet e shtetasve të huaj.



STRUKTURA SIPAS GRUPMOSHËS E SHTETASVE TË HUAJ QË KANË HYRË NË VENDIN TONË

2017	
GRUPMOSHA	%
NËN 15 VJEÇ	6 %
15-24	9 %
25-44	42 %
45-64	35 %
MBI 65 VJEÇ	8 %

SA GRA DHE SA BURRA?

Referuar të dhënave të vitit 2017, hyrjet e shtetasve të huaj si për qëllime personale ashtu edhe për qëllime biznesi dominohen nga burrat.

Udhëtime për qëllime personale
janë udhëtime që zakonisht bëhen për pushime apo vizita të ndryshme tek miqtë dhe të afërmit.

Udhëtime për biznes
janë udhëtime që bëhen për qëllime me natyrë profesionale apo studimore (seminare, takime biznesi, pjesëmarrje në takime profesionale sportive apo kulturore, etj.)

QËLLIME PERSONALE



15%



85%

QËLLIME BIZNESI



13%



87%

VIZITA DITORE APO NETË QËNDRIMI?

Në periudhën 2013-2017, numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi (ku përfshihen vizitorët që qëndrojnë të paktën një natë në hotel apo në struktura akomoduese të tjera, tek të afërmit, shtëpitë e tyre, etj.) zënë mesatarisht 89,4 % të hyrjeve gjithësej, duke u rritur me 13,0 %. Në vitin 2017, numri i

vizitorëve të huaj me netë qëndrimi është rritur me 14,1 %, krahasuar me vitin 2016. Ndërsa numri i vizitorëve ditorë, për harkun kohor 2013-2017, është 1,3 milionë, duke u rritur mesatarisht 39,0 %. Në vitin 2017, numri i vizitorëve ditorë është ulur me 42,2 %, krahasuar me vitin 2016.

TABELA 2. NUMRI I VIZITORËVE TË HUAJ ME NETË QËNDRIMI DHE DITORË, NË MIJË

PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
HYRJE GJITHSEJ	3.256	3.673	4.131	4.736	5.118
VIZITORË ME NETË QËNDRIMI	2.857	3.341	3.784	4.070	4.643
VIZITORË DITORË	220	127	162	507	293

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe INSTAT

PSE UDHËTOJNË?

Në periudhën 2013-2017, hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime personale: (pushime, vizitë në të afërm, trajtim shëndetësor, qëllime fetare, etj.) zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj, mesatarisht 98,7 %. Numri i hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime personale në këtë hark kohor është rritur mesatarisht me 12,1 %. Ndërsa hyrjet për qëllime biznesi zënë 1,3 % të hyrjeve gjithësej, duke u rritur mesatarisht 10,2 %.

TABELA 3. HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ SIPAS QËLLIMIT KRYESOR TË VIZITËS, NË MIJË


NR.	PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
1+2	HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ (GJITHSEJ)	3.256	3.673	4.131	4.736	5.118
1	PERSONALE	3.206	3.624	4.089	4.678	5.049
1.1	-PUSHIME	1.271	1.315	1.579	1.920	2.371
1.2	-TË TJERA QËLLIME PERSONALE	1.935	2.309	2.510	2.758	2.678
2	BIZNESI DHE PROFESIONALE	50	48	42	59	69

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe INSTAT

SA SHPENZOJNË?

Në periudhën 2013-2017, shpenzimet e jo-rezidentëve në Shqipëri kanë qënë 1.044.839 milionë lekë. Rritja mesatare e këtyre shpezimeve për këtë periudhë është rreth 8,5 %. Shpenzime të kryera nga jo-rezidentët për qëllime personale zënë mestarisht 79,4 % dhe për qëllime biznesi zënë 20,6 % të shpenzimeve gjithsej.


FIGURA 3. SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI, NË MILIONË LEK



Burimi: Banka e Shqipërisë

Shtetasit e huaj, referuar të dhënave të vitit 2017, kanë kaluar mesatarisht 4,2 netë qëndrimi në Shqipëri, duke shpenzuar mesatarisht 63 euro në ditë. Shtetasit e huaj (jo rezidentë) për vitin 2017, kanë qëndruar kryesisht në hotel (79 %) dhe kanë ardhur me makina private (75%). Shtetasit e huaj që preferojnë të vizitojnë Shqipërinë, për vitin 2017, janë shtetasit nga Kosova.

Shqipëria destinacion i preferuar (2017)



- shteti që na preferon:
Kosova



- netë qëndrimi mesatar:
4,2 ditë




- shpenzimet mesatare
ditore për person:
63 Euro



- vendqëndrimi:
Hotel (79%)



- mjeti transportit:
Makinë private (75%)



Kosovarët



netë qëndrimi mesatar:
3,8 ditë



87 % për pushime



83 % qëndrojnë në hotel



shpenzimet mesatare
ditore për person: **55 Euro**

86%

14%



Maqedonasit



netë qëndrimi mesatar:
3,6 ditë



78 % për pushime




74 % qëndrojnë në hotel



shpenzimet mesatare
ditore për person: **55 Euro**

90%

10%



Mali i Zi



netë qëndrimi mesatar:
2,7 ditë



67 % për pushime



93 % qëndrojnë në hotel



shpenzimet mesatare
ditore për person: **105 Euro**

86%

14%



Grekët



netë qëndrimi mesatar:
3,7 ditë



63 % për pushime



78 % qëndrojnë në hotel



shpenzimet mesatare
ditore për person: **78 Euro**

75%

22%

3%



Italianët



netë qëndrimi mesatar:
6,2 ditë



75 % për pushime



78 % qëndrojnë në hotel



shpenzimet mesatare
ditore për person: **92 Euro**

49%

3%

28%


20%



2. Karaktestikat kryesore të udhëtimeve të shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit

Në periudhën 2013-2017, daljet e shtetasve shqiptarë jashtë vendit ka qënë 22,6 milionë persona, me tendecë rritje mesatarisht prej 7,2 %. Në vitin 2017, daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 6,9 %, krahasuar me vitin 2016. Shqiptarët udhëtojnë më shumë për pushime verore. Daljet e rezidentëve shqiptarë jashtë vendit kulmojnë në muajin gusht, referuar të dhënave të vitit 2017.

FIGURA 4. SHPËRNDARJA MUJORE E DALJEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË JASHTË VENDIT, 2017



Në periudhën 2013-2017 shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit kanë qënë 854.547 milionë lekë, duke u rritur mesatarisht me 2,2 %. Në vitin 2017, shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit janë rritur me 8,1 %, krahasuar me vitin 2016. Shpenzimet e rezidentëve për udhëtime personale zënë pjesën më të madhe, mesatarisht 75,9 %, dhe shpenzimet për udhëdhime biznesi dhe profesionale 24,1 % të shpenzimeve gjithsej.

TABELA 4. TREGUES MBI SHPENZIMET E SHTETASVE SHQIPTARË (REZIDENTË) JASHTË VENDIT

PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
DALJET ('000)	3.928	4.146	4.504	4.852	5.186
SHPENZIME TË SHTETASVE SHQIPTARË (REZIDENTË) JASHTË VENDIT (MLN LEKË) NGA TË CILAT:	165.583	178.154	165.135	166.148	179.527
UDHËTIME PERSONALE (MLN LEKË)	116.024	133.959	116.010	117.330	129.526
UDHËTIME BIZNESI DHE PROFESIONALE (MLN LEKË)	40.260	33.753	39.930	39.365	40.953
SHPENZIME PËR TRANSPORT (MLN LEKË)	9.299	10.442	9.195	9.453	9.048
KOHA MESATARE E QËNDRIMIT (DITË)	7	7	7	10	8

Burimi: Banka e Shqipërisë


Shtetasit rezidentë shqiptarë, referuar të dhënave të vitit 2017, kanë kaluar mesatarisht 7,8 netë qëndrimi jashtë vendit, duke shpenzuar mesatarisht 56 Euro në ditë. Daljet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit për vitin 2017, kanë qënë kryesisht për qëllim pushimesh (rreth 55 % të daljeve) dhe vizita te miqtë e të afërmit (rreth 31 % të daljeve).

TË DASHURUAR PAS PUSHIMEVE...

TË PREFERUARAT E REZIDENTËVE SHQIPTARË PËR PUSHIME JASHTË VENDIT (2017)

- DESTINACIONI I PREFERUAR: **GREQIA**
- NETË QËNDRIMI MESATARE: **5,7 NETË**
- SHPENZIMET MESATARE DITORE PËR PERSON: **46 EURO**
- VENDQËNDRIMI: **HOTEL (59 %)**
- MJETE TRANSPORTI: **MAKINË PRIVATE (58 %)**





Të preferuarat e rezidentëve shqiptarë për pushime jashtë vendit (2017)



Greqia 28 %
5,6 Netë qëndrimi



Italia 20 %
9,6 Netë qëndrimi



Kosova 16 %
1,6 Netë qëndrimi



Maqedonia 13 %
2,4 Netë qëndrimi




Mali i Zi 6 %
2,6 Netë qëndrimi



Gjermania 3 %
10,8 Netë qëndrimi



**Shpenzimi
mesatar
46 Euro**



58%

12%


17%

13%

3. Sa i rëndësishëm është turizmi në ekonomi?

Në periudhën 2013-2017, shpenzimet e turistëve të huaj (jo-rezidentë) në vendin tonë ndaj PBB janë mesatarisht 13,3 %, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit tonë ndaj PBB janë mesatarish 11,2 %. Në vitin 2017, shpenzimet e turistëve të huaj (jo-rezidentë) në vendin tonë ndaj PBB janë 14,9 %, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë (rezidentë) jashtë vendit tonë ndaj PBB janë 11,0 %.

FIGURA 5. PESHA E SHPENZIMEVE TË VIZITORËVE TË HUAJ (SI EKSPORT) NDAJ TOTALIT TË EKSPORTIT (%)



Aktivitetet e lidhura direkt me turizmin, gjeneruan rreth 39 miliard lekë vlerë të shtuar gjatë vitit 2017, duke kontribuar me rreth 2,5 % në PBB.

Duke marrë në konsideratë efektet indirekte të shpenzimeve të turistëve në aktivitete të tjera ekonomike, ky kontribut është edhe më i lartë.

Turizmi përfshin aktivitetet:

Akomodim, Shërbime ushqimi dhe pije, Agjenci udhëtimi, operator turistik, qera e makinave dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit.




TABELA 5. VLERA E SHTUAR SIPAS INDUSTRIVE TË TURIZMIT

INDUSTRI TË	NVE REV.2 2-SHIFRORE	VLERA E SHTUAR (MLN LEKË)				
		2013	2014	2015	2016	2017
INDUSTRI TË E TURIZMIT	55;56;77;79	27.339	28.332	30.785	34.065	39.234
AKOMODIMI (GJITHSEJ)	55	3.615	4.158	4.709	6.291	8.548
SHËRBIME USHQIMI DHE PIJE (GJITHSEJ)	56	19.600	20.275	21.489	23.255	25.515
AGJENCI UDHËTIMI, OPERATOR TURISTIK, QERA E MAKINAVE DHE TË TJERA AKTIVITETE TË SHËRBIMIT TË REZERVIMIT (GJITHSEJ)	77;79	4.124	3.900	4.587	4.518	5.071

Burimi: Llogaritë Kombëtare, INSTAT

NUMRI I TURISTËVE PËR ÇDO TË PUNËSUAR

Gjatë vitit 2016 në vendin tonë erdhën rreth 4,7 milionë shtetas të huaj, ndërsa vetëm të punësuarit në aktivitetet e lidhura direkt me turizmin janë rreth 30 mijë persona, që do të thotë çdo i punësuar në këto aktivitete i shërben dhe kujdeset për rreth 157 vizitor të huaj.


TABELA 6. NUMRI I TË PUNËSUARVE SIPAS INDUSTRIVE TË TURIZMIT

INDUSTRI TË	NVE REV.2 2-SHIFRORE	NUMËR I TË PUNËSUARVE				
		2012	2013	2014	2015	2016
INDUSTRI TË E TURIZMIT	55;56;77;79	13.467	17.138	19.208	21.286	30.069
AKOMODIMI (GJITHSEJ)	55	2.105	2.467	3.344	3.836	4.718
SHËRBIME USHQIMI DHE PIJE (GJITHSEJ)	56	10.572	13.667	14.713	16.221	23.732
AGJENCI UDHËTIMI, OPERATOR TURISTIK, QERA E MAKINAVE DHE TË TJERA AKTIVITETE TË SHËRBIMIT TË REZERVIMIT (GJITHSEJ)	77;79	790	1.004	1.151	1.229	1.649

Burimi: Anketa strukturore pranë ndërmarrjeve

4. Kapacitetet akomoduese në Shqipëri


Në vitin 2016, në gjithë vendin funksionuan 1.242 struktura akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afat-shkurtra). Numri gjithsej i dhomave në këto struktura ishte 17.692 dhe shtretërit ishin 41.376 mijë. Gjatë viteve 2013-2016, numri gjithsej i strukturave akomoduese (që funksiononin gjatë periudhës) u rrit mesatarisht me 20,3 % dhe numri i shtretërve në to u rrit mesatarisht 13,3 %.

TABELA 7 . TË DHËNA MBI NJËSITË AKOMODUESE, 2012-2016

PËRSHKRIMI	2012	2013	2014	2015	2016
NUMRI I NJËSIVE AKOMODUESE	632	718	836	905	1.242
NUMRI I DHOMAVE GJITHSEJ	14.652	14.146	15.081	12.986	17.692
NUMRI I SHTRETËRVE	32.004	29.737	32.879	29.903	41.376
KAPACITETI (SHTRETËR PËR 1000 BANORË)	11.0	10.3	11.4	10.4	14.4

Burimi: Anketa strukturore pranë ndërmarrjeve

FIGURA 6. KAPACITETI I NJËSIVE AKOMODUESE NË VENDIN TONË, 2012-2016



Gjatë viteve 2013-2017, numri i lejeve për ndërtim hotelesh ishte 134. Në vitin 2017 u dhanë 53 leje për ndërtim hotelesh, duke u rritur rreth 5 herë, krahasuar me një vit më parë.

TABELA 8. TREGUES TË LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR NJËSI AKOMODUESE

PËRSHKRIMI	HOTELE DHE TË NGJASHME				
	2013	2014	2015	2016	2017
NUMRI I LEJEVE PËR NDËRTIM HOTELESH	62	5	3	11	53
SIPËRFAQE - 000/M2	41	26	6	15	89
VLERA E PËRAFËRT (MILION LEKË)	1.205	811	162	1.246	2.909

Burimi: INSTAT

5. Aktivitete të tjera turistike

Në periudhën 2013-2017, numri vizitorëve që kanë vizituar parqet arkeologjike, muzetë, kalatë dhe monumente të tjerë, ka qënë afërsisht 2,4 milion persona me një rritje mesatare vjetore 19,5 %. Në vitin 2017, numri vizitorëve që kanë vizituar parqet arkeologjike, muzetë, kalatë dhe monumente të tjerë është rritur me 20,6 %, krahasuar me një vit më parë.

Në këtë hark kohor, numri i vizitoreve që kanë vizituar kala dhe monumete të tjerë, ka pasur rritje mesatare vjetore më të lartë me 51,5 % i ndjekur nga numri i vizitorëve në parqet arkeologjike me 21,7 %, dhe atyre në muze 7,2 %. Në vitin 2017, numri i vizitoreve në muze është rritur me 29,7 %, i ndjekur nga numri i vizitorëve që kanë vizituar kala dhe monumete të tjerë me 22,2 % dhe vizitorëve në parqet arkeologjike me 13,3 %.

TABELA 9. VIZITORË NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA E MONUMENTE

PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
NUMRI I VIZITORËVE NË PARQE ARKEOLOGJIKE	121.836	175.472	209.547	230.188	260.888
NUMRI I VIZITORËVE NË MUZE	161.183	135.578	131.808	154.965	200.986
NUMRI I VIZITORËVE NË KALA E MONUMENTE TË TJERË	42.786	93.194	119.389	164.544	201.148
NUMRI I VIZITORËVE GJITHSEJ	325.805	404.244	460.744	549.697	663.022

Burimi: Ministria e Kulturës

Aneksi 1:

TABELA 10. HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ SIPAS RAJONEVE

PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
GJIITHSEJ	3.255.98	3.672.591	4.131.242	4.735.511	5.117.700
I. AFRIKA	919	859	2.973	1.077	2.080
TUNIZIA	160	148	581	186	289
AFRIKA E JUGUT	311	315	396	416	1.199
II. AMERIKA	73.291	90.084	96.763	103.839	123.729
KANADA	12.430	15.468	15.199	16.436	17.411
SHBA	57.610	70.708	74.887	81.900	97.786
III. AZIA LINDORE DHE PAQËSORI	23.628	30.874	33.032	35.894	53.533
KINA	3.961	3.882	4.307	6.256	10.584
KOREA	4.066	6.883	7.049	6.151	9.649
IV. LINDJA E MESME	3.944	2.607	3.604	4.324	4.722
EGJIPT	844	641	692	702	892
ARABIA SAUDITE	380	481	873	1.886	1.820
V. AZIA E JUGUT	961	1.274	1.636	1.699	2.216
INDIA	527	685	707	1.059	1.508
IRAN	256	315	660	299	325

VI. EVROPA	2.963.583	3.423.665	3.759.423	4.485.405	4.686.695
EVROPA QENDRORE / LINDORE	112.333	163.006	151.457	182.581	269.261
BULLGARIA	20.802	27.201	23.558	35.766	40.488
POLONIA	35.751	58.910	50.278	66.017	114.582
- EVROPA VERIORE	119.016	137.308	125.513	149.965	204.099
SUEDIA	14.646	19.914	14.003	20.801	34.101
MBRETËRIA E BASHKUAR	80.373	90.937	87.945	102.628	127.333
- EVROPA JUGORE	2.467.195	2.821.920	3.169.174	3.855.617	3.810.337
MAQEDONIA	432.646	514.459	515.125	566.761	671.570
KOSOVA	1.324.605	1.379.240	1.698.590	2.157.013	1.745.973
- EVROPA PERËNDIMORE	210.845	237.760	246.811	221.492	316.120
GJERMANIA	79.925	89.500	108.560	82.527	121.604
ZVICRA	35.763	40.647	32.171	36.730	54.051
- EVROPA LINDORE / MESDHEUT	54.194	63.671	66.468	75.750	86.878
IZRAEL	3.032	3.073	4.165	5.296	5.478
TURQIA	50.209	59.312	60.066	69.451	79.639
VII. TË TJERA	189.662	123.228	233.811	103.273	244.725

TABELA 11. TREGUESIT MAKROEKONOMIK NDAJ PBB, NË %

PËRSHKRIMI	2013	2014	2015	2016	2017
SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ (INBOUND) MBI PBB	11,5	12,8	13,2	14,2	14,9
SHPENZIMET E TURISTËVE VENDAS JASHTË (OUTBOUND) MBI PBB	11,6	12,0	10,9	10,6	11,0
BILANCI I TURIZMIT (SHPENZIMET BRENDË VENDIT) MINUS JASHTË VENDIT) MBI PBB	0,0	0,8	2,3	3,6	3,9
HAPJA NË TURIZËM (SHPENZIMET BRENDË PLUS JASHTË VENDIT) MBI PBB	23,1	24,9	24,1	24,9	25,9
MBULIMI I TURIZMIT (SHPENZIMET BRENDË VENDIT MBI ATO JASHTË VENDIT)	99,6	106,9	121,1	134,1	135,6
SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ BRENDË VENDIT (INBOUND) NDAJ EKSPORTIT TË SHËRBIMEVE	64,6	68,2	66,7	63,9	59,9
SHPENZIMET E TURISTËVE TË HUAJ BRENDË VENDIT (INBOUND) NDAJ TOTALIT TË EKSPORTEVE TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE	40,1	45,5	48,3	49,2	46,9
SHPENZIMET E TURISTËVE VENDAS JASHTË VENDIT (OUTBOUND) NDAJ IMPORTIT TË SHËRBIMEVE	74,7	76,9	74,3	71,3	71,0
SHPENZIMET E TURISTËVE VENDAS JASHTË VENDIT (OUTBOUND NDAJ TOTALIT TË IMPORTEVE TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE	24,6	25,5	24,4	23,2	23,4

Burimi: Banka e Shqipërisë